



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 35.3 dhe 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe neneve 30.3 dhe 45.2 të Statutit të Komunës, nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 25 nëntor 2015, miratoi:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN E MANDATEVE TË KËSHILLTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 1

Përbërja e Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ndryshohet si vijon:

z.Bahri Blakçori, emërohet në përbërjen e Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, në cilësinë e kryesuesit.

Ndryshimi i përbërjes së Komisionit bëhet për shkak të dorëheqjes së përvokueshme të z.Afrim Shabani nga cilësia e këshilltarit të Kuvendit të Komunës dhe ish kryesues Komisionit për verifikimin e mandateve

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr.01-006-23039, për themelimin e Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, dt. 13 mars 2014.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë, përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-99949
Podujevë,
25 nëntor 2015



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi